



C.nr. 125/2001

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, gjykatësi Zenel Leku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z.G.,A.G.,S.G.,V.G.,A.G., dhe D.G., të gjithë nga M., komuna P., të cilët i përfaqëson me autorizim Sh. G. nga M. P., kundër të paditurit R. (H.) G. nga M. P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R. Z., avokat nga P., për vërtetim pronësie, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur në prani të ndërgjyqësve, me dt. 07.05.2013, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. MIRATOHET PJESRISHT E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësve Z.G.,A.G.,S.G.,V.G.,A.G., dhe D.G., të gjithë nga M., komuna P. dhe **VERTETOHET** se paditësit si trashëgimtar të të ndjerit N. G. janë bashkëpronarë secili nga 1/12 të ngastrës kadastrale nr. 817/1 plani dhe skica 4/8 vendi i quajtur “Njelmsina”, me kulturë arë (3) me sipërfaqe prej  $S = 0.30.34ha$ , tokë rurale, tipi i pronës private, si dhe ngastrës kadastrale nr. 817/4 si rrugë private, me sipërfaqe prej  $S = 0.01.37ha$ , sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr: UL-71914050-00120 Zona Kadastrale Matiqan.

**II.DETYROHET** i padituri që paditësve t’ua pranoj këtë të drejtë pronësie si dhe të lejoj regjistrimin e paluajtshmerive të përmendura si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, në emër të paditësve si pronar të vetëm në regjistrin e paluajtshmerise në Komunën e Prishtinës – në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**III. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve Z.G.,A.G.,S.G.,V.G.,A.G., dhe D.G., të gjithë nga M., komuna P., me të cilën kanë kërkuar që të VERTETOHET se janë pronar të tërë sipërfaqes së ngastrës kadastrale nr.817/2, në sipërfaqe prej 0.05.00ha, në emër të Xh. I. nga M. dhe pjesë nga ngastra kadastrale nr.823/24, në emër të E. C., **SI E PABAZUAR**.

**IV.** Ndryshohet Aktvendimi E.nr.1306/05 datë 13.12.2005 për caktimin e masës së përkohshme ashtu që tani **CAKTOHET masa e sigurisë** dhe të paditurit R. G. i **NDALOHET** tjetërsimi, ngarkimi me hipotekë apo në ndonjë formë tjetër i paluajtshmerive në ngastrën kadastrale nr. 817/1 plani dhe skica 4/8 vendi i quajtur “Njelmsina”, me kulturë arë (3) me sipërfaqe prej  $S = 0.30.34ha$ , toke rurale, tipi i pronës private, si dhe ngastrës kadastrale nr. 817/4 si rrugë private, me sipërfaqe prej  $S = 0.01.37ha$ , sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr: UL-71914050-00120 Zona Kadastrale Matiqan.

**V. DETYROHET** i padituri që paditësve, në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ua paguaj shumën prej 100€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi N. G. me parashtresën nr. 96/97 datë 08.09.1997 ka bërë zgjerimin e padisë dhe, përveq të paditurit MDD "R." L., si të paditur në këtë kontest ka përfshi edhe të paditurin H. (R.) G.. Me datën 21.12.2000 ka paraqit propozim për vazhdim të prodesurës ngase gjatë vitit 1999, për shkak të luftës, është ndërpre procedura në lëndën c.nr.96/97. Me parashtresën e datës 06.12.2005 ka bërë ndryshimin e padisë dhe në vend të paditurit H. G. si të paditur ka përfshi të birin e tij R. G. i cili është shpallë trashëgimtar i vetëm i të ndjerit H. G.. Gjykata me aktvendim e marrë në seancën e datës 12.03.2010, sipas propozimit të trashëgimtarëve të paditësit N. G., i cili ka vdekur me datën 23.08.2007, ka vendosur që të vazhdohet procedura me paditës të ri. Trashëgimtarët e paditësit Z.G.,A.G.,S.G.,V.G.,A.G., dhe D.G., me parashtresën e datës 12.03.2010, kanë kërkuar që të vërtetohet se pjesa ideale e ngastrës kadastrale 817 e evidentuar në fletën poseduese nr.120 ZK Matiqan, në sipërfaqe prej 30 ari në emër të paditurit R. G. të cilën e ka trashëguar nga babai i tij H. G., ish i paditur, sepse e njëjta ngastër ka pasur numër 245 dhe ka qenë objekt i kontratës nr.1443/66 dt.01.08.1966 të lidhur në mes të N. G. si shitës dhe PIK K. E., P. si blerës e cila është shpall Nule me Aktgjykimin e Gjykataës Komonale në Prishtinë C.nr.545/94 dt.10.04.1995. Me parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë datë 10.09.2012 i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin objektiv të kërkesëpadisë në atë drejtim që në të ardhmen kërkesëpadia e cila kishte të bënte me sipërfaqen prej 30 ari të ngastrës 817-0, tani ka të bëjë me ½ të sipërfaqës së ngastrës 817-1 e cila është në sipërfaqe prej 030.34 ha një pjesë të ngastrës 817-4 e cila është në sipërfaqe prej 01.37 ha, tërë sipërfaqen e ngastrës 817-2, e cila është në sipërfaqe prej 0,05.00ha, e cila është në emër të Xh. I. nga M. dhe pjesa nga ngastra nr.823-24 e cila është në emër të E. C.. I autorizuar i paditësve në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë precizimit të kërkesëpadisë bërë me datën 10.09.2012 dhe ka shtuar se gjendja faktike në teren deri në vitin 2005 përkatësisht 2006 ka qenë ku 51ha i ka pas në shfrytëzim H. G., ndërsa pjesën tjetër prej 43 ha e ka pas në shfrytëzim N. G., e që vërtetohet edhe me ekspertizën e ekspertit M. P., e cila gjendje ka qenë deri në vitin 2005 përkatësisht 2006 kur është bërë trashëgimia dhe tani i padituri ka hjek dorë prej pjesës së shfrytëzimit të pjesës së poshtme dhe ka filluar me e shfrytëzu edhe ½ të pjesës të cilën ne e kemi shfrytëzuar, me arsyetim se ky e njeh vetëm fletën poseduese qysh është në skicë. Nga arsyet e paraqitura i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërsi e bazuar ashtu siç është precizuar me parashtresën e datës 10.09.2012. Shpenizmet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit në parashtresa me shkrim dhe gjatë seancave gjyqësore e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me pretendim se i padituri më tepër se 40 vjet është në posedim të ligjshëm të paluajtshmërisë lëndore kontestuese, gjendja faktike e së cilës nuk ka ndryshuar asnjëherë dhe asnjëherë për këto vite nuk është deposeduar nga paluajtshmëria kontestuese, kjo paluajtshmëri nuk ka qenë asnjëherë në posedim të KBI-së në F. K.. I padituri së bashku me paraardhësin e tij babain H. R. G. është titullar i paluajtshmërisë lëndore kontestuese tek organi kompetent i gjeodezisë që nga viti 1968, duke e dëshmuar me ekstraktin nga lista poseduese nr. 11 përkatësisht fletëposedimin e dt. 03. 10.1978. Këtë paluajtshmëri e ka në posedim dhe shfrytëzim edhe i padituri R. G. poashtu titullar i kësaj paluajtshmërie në bazë të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71914050-00120 e dt. 23. 11. 2011, që do të thot për 44 vite rresht është posedues ligjor dhe pronar i paluajtshmerisë kontestuese me dokument të vlefshëm nga organi komunal dhe asnjëherë nuk është kontestuar nga askush deri më zgjerimin e padisë nga ana e paditësve, ku shifet se ai zgjerim është bërë në mënyrë të jashtligjshme, sepse është bërë pasi ka përfunduar procedura me KBI-në, pra edhe ky zgjerim i padisë së paditësve është për pas 29 vite nga posedimi i paraardhësit juridik të babait H. dhe tani të paditurit R. G.. Në lidhje me ekspertizat e ekspertëve gjyqësorë, që të gjitha në mënyrë të qartë dhe të drjetë e kanë vërtetuar dhe konstatuar se paluajtshmëria kontestuese gjithëherë ka qenë në emër të H. R. G., ku bartja është bërë në prani të Komisionit dhe tre dëshmitarëve, procesverbali është nënshkruar pas asnjë vërejtje, deri sa është paraqitur ndryshimi i padisë nga ana e paditësve më dt. 16. 10. 2007, nuk është kompetencë e ekspertit që ka kërkuar bazën e paluajtshmërisë, por paraardhësi juridik i R. G. këtë paluajtshmëri e ka blerë nga mixha i tij në vitin 1966,

ndërsa e ka bartur në emër të vet në vitin 1968, lista poseduese nr. 11 e dt. 23. 09. 1968, të gjitha këto kanë siguruar bazën ligjore se i padituri është mbajtur me mirëbesim i paluajtshmerisë kontestuese dhe në bazë të nenit 28 par. 4 të LTHJP i cili ka qenë në zbatim si dhe ndaj ligjit të tanishëm i cili është në zbatim, dispozita e nenit 40 par. 1 i ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, që do të thotë se në këto dy ligje me fitim me parashkrim e ka fituar të drejtën e proënsisë në paluajtshmerinë kontestuese, këte të drejtë e ka fituar edhe përmes regjistrimit sipas dispozitës së nenit 41 të ligjit të lartëcekur, sepse regjistrimi ka zgjatë më se 20 vite në emër të paditurit, përkatësisht paraardhësit juridik të tij sepse e ka pas në posedim pronësorë dhe të gjitha këto prova me shkrim të lëshuara nga organet kompetente vërtetojnë se padia dhe kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore të cilën gjykata duhet t'a refuzoj si të pabazuar. Në lidhje me ekspertizën e fundit të ekspertit A. A. theksoj se asgjë tjetër nuk ka në të, përveç përshkrime të bëra nga kolegët e tij të mëparshëm, por e ka ngatërruar faqen e fundit me fakte dhe prova sepse gjendja faktike e paluajtshmerisë nuk ka ndryshuar as atëherë e as tani dhe kjo sipas planit rregullativ "Mati" të Kuvendit Komunal të Prishtinës, të datës 06. 01. 2005.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt. 07.05.2013 në prani të ndërgjyqësve gjykata bëri administrimin e provave të gjithmbarshme e si me të rëndësishme nxori: aktgjykim i Gjykatës Komonale në Prishtinë nr.54/94 datës 10.04.1995, aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1020/96 datës 27.12.1996, zgjerimi i padisë i datës 08.09.1997, procesverbalet me nr.C.nr.545/94 datës 27.11.1997, i datës 23.01.1998, procesverbalet e lëndës me nr.C.nr.96/97 të datës 14.04.1998, të datës 28.05.1998, të datës 17.06.1998, konstatimi i ekspertit të lëmisë së Gjeodezisë M. P. i datës 07.09.1998, listat poseduese nr.120, nr.389, Lista poseduese nr.389 të gjitha të datës 07.09.1998, fleta poseduese nr.11 e datës 23.09.1968, fleta poseduese nr.11 e datës 03.10.1978, Aktvendimi mbi trashgiminë T.nr.361/2005 i datës 03.10.2005, çertifikata mbi të drejtën e pronës së palujtëshme me nr.UL-71914050-00120 e datës 23.11.2011 dhe kopja e planit, Konstatimi i ekspertit të gjeodezisë J. V. M. i datës 17.10.1994, ekspertiza e Gjeodezisë e ekspertit A.A. e datës 22.11.2010, padia me nr.2631/2006 dhe plani Rregullativ Mati i datës 01.06.2005 dhe skicat e planit urbanistik.

Pas vlerësimit të provave të përmendura bazuar edhe në faktet jokontestuese në mes të ndërgjyqësve, gjykata në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetoi se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar e si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike:

Në mes të ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësit Z.G.,A.G.,S.G.,V.G.,A.G., dhe D.G. janë trashëgimtarë të të ndjerit N. G. (i cili ka vdekur me datën 23.08.2007 dhe ishte paditës në këtë çështje).

Nga Aktgjykim i Gjykatës Komonale në Prishtinë nr.54/94 datës 10.04.1995, vërtetohet se paditësi N.G. tani i ndjerë me MDD "R." në Ll. ka lidhur kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmerisë me numër Vr.nr.1443/66 datë 01.08.1966. Sipas kësaj kontrate N. G. ja ka shitur KBI "K.E.", tani pasardhësi juridik MDD "R." në Ll., pasurin e patundshme të regjistruar në fletën poseduese nr.221 si ngastër kadastrale nr.245, në vendin e quajtur "sllanishte" në sipërfaqe prej 0.30.00 ha dhe ngastrën kadastrale 245 me kulturë arë e klasit II në vendin e quajtur "sllanishte" me sipërfaqe prej 0.14.00 ha, për shumën prej 917,00 dinar të atëhershëm. Kjo gjykatë, me këtë vendim, sipas konstatimeve të ekspertit të gjeodezisë J. M. të datës 07.11.1994, ka vërtetuar se patundshmëria e cila ka qenë lëndë e kontratës së shitblerjes numër Vr.nr.1443/66 datë 01.08.1966 tani evidentohet si ngastër kadastrale 823/1 dhe ngastra 817, që gjenden në vendin e quajtur "sllanishte", me kulturë arë e klasit III dhe IV, në sipërfaqe prej 0.14.00ha dhe 0.30.00ha në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.44.00ha.

Me këtë aktgjykim në paragrafin e II-të të tij është detyruar e paditura në atë kohë MDD “R.” në Ll. që paditësit N. G. t’ia kthej në pronësi dhe posedim pjesën e ngastër kadastrale 823/1 e cila gjendet në vendin e quajtur “sllanishte”, me kulturë arë e klasit III dhe IV, në sipërfaqe prej 0.14.00ha, që evidentohet sipas fletës poseduese nr.389 e në posedim të KBI “K.E.” F. K.. Me paragrafin IV të aktgjykimit është detyruar e paditura MDD “R.” në Ll. që paditësit t’ia paguaj shumën prej 1.489,00 dinar për pjesën e ngastrës 817 e cila nuk mund ti kthehet në pronësi dhe posedim. Kjo gjykatë ka konstatu se paditësit nuk është e mundur që ti kthehet në posedim ngastra kadastrale nr.817, e cila ka qen lëndë e kontratës nule, sepse gjendet në posedim të personit të tretë.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin numër Ac.nr.1020/96 datës 27.12.1996 ka prishur këtë aktgjykim në paragrafin 4 dhe 5. Kjo gjykata ka vlerësuar se nga eksperti i gjeodezisë rrjedh se në evidencën kadastrale nuk është shënuar baza juridike në bazë të se cilës ngastra kadastrale nr.817 është regjistruar, pas hyrjes në fuqi të matjes shtetërore të datës 01.01.1979, në emër të A. G. (duhet të jet H. N.G.), e cila në bazë të kontratës së shitblerjes e cila me vendimin e lartshënuar është anuluar ka qenë e evidentuar në poseduesin KBI “K. E.”. Kjo gjykatë ka vlerësuar se në këtë rast ka qenë e domosdoshme që të dëgjohet poseduesi se në çfarë mënyre dhe kur ka ardhur deri të posedimi i patundshmërisë kontestuese. Kjo gjykatë ka theksuar se duke u nisur nga fakti që posedimi mund të dorëzohet vetëm nga personi që e posedon, paditësi përmes vendimit të plotfuqishëm me të cilin është vlerësuar kontrata nulë, mund të kërkoj kthimin e sendit vetëm nga personi i cili atë e posedon.

Pas kësaj paditësi N. G. ka bërë zgjerimin e padisë me datën 08.09.1997 dhe si palë të paditur në këtë kontest ka përfshi edhe të paditurin H. (R.) G.. Këtë me arsyetim se kjo gjykatë ka nxjerr aktgjykim të plotfuqishëm me të cilin është vërtetuar se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1443/66 datë 01.08.1966 është nule ndërsa pjesa e patundshmërisë ngastra kadastrale nr.817 në sipërfaqe prej 0.30.00ha e cila ka qenë lëndë e kësaj kontrate pa bazë juridike gjendet në posedim të të paditurit H. R. G..

Eksperti i gjeodezisë J.V.M., në mendimin dhe konstatimin e tij të datës 07.11.1994, ka konstatuar se në evidencën kadastrale nuk është shënuar baza juridike ose ndonjë bazë tjetër se në çfar baze ngastra kadastrale nr.817( është regjistruar, pas hyrjes në fuqi të matjes shtetërore të datës 01.01.1979) nga fleta poseduese nr.143 ka kaluar në fletën poseduese 120 në emër të H. (R.) G..

Për të sqaruar rrethanat se mbi çfarë baze i padituri H. G. ka ardhur në posedim të patundshmërisë kontestuese pjesës prej 30 ari nga ngastra kadastrale 817, kjo gjykata gjatë procesit të rigjykimit lidhur me paragrafin IV të aktgjykimit të lartshënuar ka dëgjuar të paditurin H. G. në cilësi të palës. Në seancën e shqyrtimit kryesor datë 28.05.1998, në këtë gjykatë, i padituri H. G., në cilësinë e palës, ka deklaruar: *kur N. G. e ka shitur ngastrën e vet kadastrale nr.245 KK Matiqan KBI-së “K. E.”, e njëjta pas kontratës është regjistruar në kadastër në “K. E.”. Unë tokën e N. kurr nuk e kamë shfrytëzuar por atë gjithnjë e ka shfrytëzuar KBI “K. E.”. Në pyetje të gjykatës se në çfar baze ngastra kontestuese evidentohet në emër të tij, ka deklaruar se : “me siguri ka ardhur deri të gabimi në kadastër me rastin e regjistrimit sepse në vitin 1972 është bërë inqizimi fotogrametrik e unë nuk jam në posedim e pjesës kontestuese të patundshmërisë as tani as që kam qenë më parë në posedim nga shitblerja e deri me tani është KBI gjegjësisht MDD “R.” si paraardhës juridik i tij. Për shkak të të theksuarave unë pranoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë sepse edhe eksperti gjeometër ka gjetur se në kadastër nuk është regjistruar kurrfarë baze sipas të cilës ngastra nr.817 evidentohet në mua, gjegjësisht në pyetje është pjesa e ngastrës 817 në sipërfaqe prej 30 ari”.* Edhe dëshmitari A. G. (djali i mixhes se paditësit dhe të paditurit), i dëgjuar në këtë çështje, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.04.1998 ka deklaruar se: *“ngastra kadastrale nr.817 i takon këtu paditësit N. G. para lidhjes së marrëveshjes*

*kontestuese të tre vëllezrit A. G. (baba i paditësit N. G.), V. dhe R. paraardhësit tanë juridik, babai im, babai i paditësit dhe i të paditurit prej atëher e kanë ndër patundshmërinë në tri pjesë, të gjithë vëllezërve iu ka takuar rreth 44 ari.*

Në këtë rast u vërtetuar se ngastra kadastrale nr. 245 në sipërfaqe prej prej 0.30.00 ha dhe sipërfaqen prej 0.14.00 ka qenë lëndë e kontratës së shitblerjes Vr.nr.1443/66 datë 01.08.1966 në mes të paditësit N. G. dhe KBI “K. E.. Kjo ngastër pas kësaj shitje ka kaluar në fletënm poseduese nr.229 për KK Matiçan në poseduesin KBI “K. E.. Gjatë procedurës së zhvilluar në këtë gjykatë për anulimin e kësaj kontrate nga eksperti i gjeodezisë J. V.M., në mendimin e tij dt.07.11.1994, është konstatu se ngastra kadastrale nga kadastri regjistruar nr.245, në sipërfaqe prej 0.44.00ha në teren nuk ekziston. Nga Vendimi i kësaj Gjykate nr.54/94 datës 10.04.1995 vërtetohet se është konsideru Nule Kontrata e latshënuar e cila për lëndë ka pasur paluajtshmërinë nga ngastra kadastrale nr. 245 në sipërfaqe prej prej 0.30.00 ha dhe sipërfaqen prej 0.14.00 ha. Kjo Gjykatë ka vërtetuar se paluajtshmëria nga ngastra kadastrale nr. 245 në sipërfaqe në sipërfaqe prej 0.44.00ha është ndarë në atë mënyrë që sipërfaqja prej 0.14.00 ha është bërë pjesë e ngastrës kadastrale 823/1 (e cila pjesë i është kthyer paditësit me këtë vendim) ndërsa sipërfaqja prej 0.30.00 ha është bërë pjesë e ngastrës 817 dhe e njëjta nuk i është kthyer paditësit. Ngastra kadastrale nr.817 ka sipërfaqen prej 0.41.71 ha e evidentuar në emër të të paditurit H. G. pa u theksuar baza sipas të cilës kjo ngastër është regjistruar pas hyrjes në fuqi të matjeve shtetore dt.01.01.1979 në emër të H. G., e cila në bazë të kontratës së lartëpërmendur ka qenë e evidentuar në emër të KBI “K. E.”. Nga deklarata e të paditurit H. G. i dëgjuar si palë në procedurë gjykata ka vërtetuar se paditësi N. G. e ka shitur ngastrën e vet kadastrale nr.245 KK Matiçan KBI-së “K. E.” dhe se e njëjta pas kontratës është regjistruar në kadastër në “K. E.”. Se i padituri H. G. këtë paluajtshmëri nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë dhe se të njëjtën e ka shfrytëzuar KBI “K. E.”. Vet i padituri në seancën e datës 28.05.1998, në pyetje të gjykatës, ka deklaruar se me siguri ka ardhur deri të gabimi në kadastër me rastin e incizimi fotogrametrik të bërë në vitin 1972 dhe se ai nuk ka qenë në posedim të pjesës kontestuese nga ngastra nr.817.

Nën rrethanat e tilla e duke e marrë për bazë fletën poseduese nr.11 datës 03.10.1978 nga e cila shihet se i padituri H. (R.) G. është evidentuar si pronar i ngastrës kadastrale nr.246, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.44.00ha si dhe duke e marrë për bazë deklaratën e dëshmitarit A. G. (djal i mixhes se paditësit dhe të paditurit) atëherë mund të vijmë në përfundim se i padituri H. G. nuk ka mundur që të jetë pronar edhe i ngastrës nr. 246 e edhe i ngastrës nr.245.

I padituri H. (R.) G. ka vdekur me datën 25.06.2005 dhe nga Aktvendimit mbi trashëgiminë,T.nr.361/2005 i datës 03.10.2005, vërtetohet se R. G., si trashëgimtar, ka trashëguar 1/1 e parcelës kadastrale nr.817, në vendin e quajtur “Ledina”, me kulturë arë e klasës së III në sipërfaqe prej 0.41.71 ha, e evidentuar sipas fletës poseduese nr.120 të datës 28.07.2005.

Pasi që kjo paluajtshmëri ka kaluar në emër të R. G. paditësit kanë bërë ndryshimin e padisë dhe si të paditur kanë përfshi R. G. si trashëgimtar i të ndjerit H. (R.) G., i cili ishte pala e paditur në këtë kontest

Nga ekspertiza e lëmis së gjeodezisë së ekspertit A. A. datë 22.11.2010 vërtetohet se ngastra kadastrale 817/0 kishte sipërfaqe prej 0.41.71 ha dhe atë deri në vitin 2006 kur i padituri e ka parcelizuar këtë ngastër në 4 pjesë. Ky ekspert duke e marrë për bazë edhe ekspertizën e ekspertit M. P., planit origjinal të punës në kohën datë 20.10.1998, pjesën grafike dhe në dy skica, ka konstatuar se tani gjendja faktike ka ndryshuar dhe se mbi këtë bazë paditësit duhet të marrin pjesë nga ngastra kadastrale nr.817/1 dhe pjesë nga ngastra kadastrale 817/4 të cilat janë në pronësi të të paditurit, pastaj pjesë nga ngastra kadastrale 817/2 pronë e Xh.I. nga M. dhe pjesë nga ngastra kadastrale nr.823/24 pronë e E. C..

Duke ju referuar kësaj ekspertize i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin objektiv të kërkesëpadisë në atë drejtim që në të ardhmen kërkesëpadija e cila kishte të bënte me sipërfaqen prej 30 ari të ngastrës 817-0, tani ka të bëjë me ½ të sipërfaqes së ngastrës 817-1 e cila është në sipërfaqe prej 030.34 ha një pjesë të ngastrës 817-4 e cila është në sipërfaqe prej 01.37 ha, tërë sipërfaqen e ngastrës 817-2, e cila është në sipërfaqe prej 0,05.00ha, e cila është në emër të Xh. I. nga M. dhe pjesa nga ngastra nr.823-24 e cila është në emër të E. C..

Gjykata vlerëson se përkundër faktit që me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate, nr.54/94 datës 10.04.1995, është vërtetuar se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.1443/66 datë 01.08.1966 është nule, ndërsa sipas nenit 104 të LMD-së është parapa që *“në rastin e anulimit të kontratës, secila palë kontraktuese ka për detyrë t’ia kthej palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në qoftë se kjo nuk ka mundës, apo nëse vetë natyra e saj që është plotësuar i kundërvihet kthimit duhet të jepet kompensim përkatës në të holla, sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, në qoftë se ligji nuk cakton diçka tjetër”*, paraardhësit të paditësve i është kthyer në pronësi dhe posedim vetëm pjesa e ngastër kadastrale 823/1 e cila gjendet në vendin e quajtur “sllanishte”, me kulturë arë e klasit III dhe IV, në sipërfaqe prej 0.14.00ha ndërsa sipërfaqja prej 0.30.00ha, pjesë e ngastrës nr.817, që ka qenë lëndë e kësaj kontrate të anuluar, nuk i është kthyer e me arsyetim se në atë kohë ka qenë në posedim të H. R. G. dhe gjithashtu as nuk i është kompensuar.

Mbi këtë bazë gjykata vlerëson se paraardhësi i paditësve ka mbetur pronar i sipërfaqes prej 0.30.00ha, pjesë e ngastrës nr.817, e regjistruar në emër të paditurit H. R. G., paraardhësi i të paditurit R. G., e regjistruar në emër të tij, pa ndonjë bazë juridike, gjë të cilën e ka pranuar edhe vet i padituri H. G., ngase kontrata e lartshënuar që për lëndë ka pasur këtë paluajtshmëri është shpall nulë me vendim gjyqësor të plotfuqishëm ( që do të thotë se nuk kemi më bazë juridike për të drejtat dhe detyrimet që do të rrjedhin nga ajo), ndërsa paraardhësit të paditësve kjo paluajtshmëri nuk i është kthyer e as kompensuar (neni 104 i LMD).

Nuk ishte kontestuese që paditësit janë trashëgimtarë të të ndjerit N. G., përkatsisht pasardhësit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit, ndërsa sipas nenit 12 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Trashëgimin i Kosovë është parapa se: *“trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Personat nga paragrafi (1) i këtij neni trashëgojnë në pjesë të barabarta”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite dhe nga arsyet e paraqitura më lartë gjykata vlerëson se paditësit si trashëgimtarë ligjor të rendit të parë i bjen që të fitojnë të drejtën e bashkëpronësisë secili nga 1/12 të ngastrës kadastrale nr. 817/1 plani dhe skica 4/8 vendi i quajtur “Njelmsina”, me kulturë arë (3) me sipërfaqe prej S = 0.30.34ha, toke rurale, tipi i pronës private, si dhe ngastrës kadastrale nr. 817/4 si rrugë private, me sipërfaqe prej S = 0.01.37ha, sipas Certifikates mbi të drejtat e pronës se paluajtshme nr: UL-71914050-00120 Zona Kadastrale Matiqan, këtë nga fakti që me daljen e gjykatës në vendshiqim dhe nga mendimi i ekspertit të Gjeodezisë A. A. është vërtetuar se tani gjendja faktike ka ndryshuar dhe se i padituri është në shfrytëzim vetëm të ngastrës kadastrale nr.817/1, me kulturë arë (3) me sipërfaqe prej S = 0.30.34ha, toke rurale, tipi i pronës private, si dhe ngastrës kadastrale nr. 817/4 si rrugë private, me sipërfaqe prej S = 0.01.37ha. Mbi bazën gjendjes faktike të ndryshuar eksperti ka konstatuar se paditësit duhet të marrë pjesë nga ngastra kadastrale nr.817/1 dhe pjesë nga ngastra kadastrale 817/4 të cilat janë në pronësi të të paditurit, pastaj pjesë nga ngastra kadastrale 817/2 pronë e Xh. I. nga M. dhe pjesë nga ngastra kadastrale nr.823/24 pronë e E. C..

Përkundër faktit që nga ky ekspert është konstatu se ka ndryshuar gjendja faktike i autorizuari i paditësve ka bërë vetëm precizimin objektiv të kërkesëpadisë dhe jo subjektiv dhe si të

paditur ka përfshi vetëm të paditurin R. G.. Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e ka refuzuar si të pabazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se janë pronar të tërë sipërfaqes së ngastrës kadastrale nr.817/2, në sipërfaqe prej 0.05.00ha, në emër të Xh. I. nga M. dhe pjesë nga ngastra kadastrale nr.823/24, në emër të E. C. ka, ngase është vërtetuar se këto paluajtshmëri nuk janë posedim dhe pronësi të të paditurit por të njëjtat janë në pronësi të personave të lartshënuar të cilët nga paditësit nuk janë përfshi si palë në procedurë dhe mbi këtë bazë të paditurit R. G. i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.03.2013 gjykata ka marr aktvendim me të cilin e ka refuzuar propozimin e të autorizurit të paditësve që kësaj lënde ti bashkohet lënda me numër C.nr.2631/06, ngase ka vlerësuar se nuk janë plotësuar në mënyr komulative kushtet për bashkim të disa kontestëve ashtu siç është parapa në paragrafin 1 dhe 3 të nenit 408 të LPK-së ,këtë nga fakti se këto konteste nuk rrjedhin ndërmjet personave të njëjtë dhe se të paditurit e paraqitura në lëndën C.nr.2631/06 nuk janë kundërshtarë të njëjtë të paraqitur në këtë lëndë dhe se nuk ekziston pëlqimi i të dy palëve për bashkim e lëndëve.

I autorizuari i të paditurit pretendon sa babai i tij H. R. G. është titullar i paluajtshmërisë lëndore kontestuese tek organi kompetent komunal gjeodezisë që nga viti 1968, nga lista poseduese nr. 11 përkatësisht fletëposedimin e dt. 03. 10.1978 dhe se këtë paluajtshmëri e ka në posedim dhe shfrytëzim edhe i padituri R. G. në bazë të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71914050-00120 e dt. 23. 11. 2011, për 44 vite rresht është posedues ligjor dhe pronar i paluajtshmerisë kontestuese dhe asnjëherë nuk është kontestuar nga askush deri më zgjerimin e padisë. Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuara këto pretendime nga fakti se vet paraardhësi i të paditurit, në kohën kurë ka qen palë i paditur në seancën e datës 28.05.1998, ka deklaruar se me siguri ka ardhur deri të gabimi në kadastër me rastin e regjistrimit sepse në vitin 1972 është bërë inqizimi fotogrametrik dhe se nuk është në posedim e pjesës kontestuese të patundshmërisë e as që ka qenë më parë në posedim. Me asgjë nuk ka provuar se mbi çfarë baze pjesa kontestuese është regjistruar në emër të paraardhësit të tij ndërsa ai ka shfrytëzuar këtë situatë dhe këtë paluajtshmëri e ka qit më emër të tij dhe përkundër ekzistimit të masës së përkohshme e ka nda në parcela dhe disa prej tyre edhe i ka shitë. Nga këto arsye gjykata vlerëson se nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e parapara ligjor nga neni 28 i LMTHJP për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, ashtu siç pretendon i autorizuari i të paditurit.

I autorizuari i të paditurit në parashtrësat me shkrim dhe gjatë seancave gjyqësore i ka propozuar gjykatës që ta heq masën e përkohshme të caktuar me Aktvendimin E.nr.1306/05 datë 13.12.2005.

Gjykata ka vendosur që në këtë çështje të ndryshohet Aktvendimi për caktimin e masës së përkohshme E.nr.1306/05 datë 13.12.2005 duke u nisur nga fakti se tani gjendemi në rrethana tjera ngase nga ekspertiza e lëmis së gjeodezisë datë 22.11.2010 vërtetohet se i padituri ngastrën kadastrale 817, për të cilën ka qen e caktuar masa e përkohshme, e ka parcelizuar në katër pjesë dhe se paditësit kërkesëpadinë që kishte të bënte me sipërfaqen prej 30 ari të ngastrës 817-0, e ka orientuar në ngastrën nr.817-1 e cila është në sipërfaqe prej 030.34 ha dhe ngastrës 817-4 e cila është në sipërfaqe prej 01.37 ha, të cilat ngastra sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës se paluajtshme nr: UL-71914050-00120 evidentohen në emër të të paditurit. Duke e marrë parasysh natyrën e kontestit, raportet në mes të palëve si dhe duke u nisur nga fakti që i padituri përkundër faktit që masa e përkohshme ka qenë në fuqi ai ka parcelizuar ngastrën 817 dhe i ka shitur disa ngastra, kështu që gjykata ka ardhë në përfundim se me ndonjë veprim tjetër apo me mos veprim, në këtë fazë të procedurës, do të rrezikohej shkaktimi i ndonjë dëmi të madh dhe të pakompensueshëm për paditësit, me çka edhe do të humbej qëllimi dhe kuptimi i kësaj mase, prandaj edhe gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 297 të LPK-së për caktimin e kësaj mase të sigurimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u bazuan ne dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 te LPK-se ashtu që është obliguar i padituri që paditësve tua paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të të ekspertizës së gjeodezisë në shumë prej 100€.

Mbi bazën e të dhënave si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 125/01, dt. 07.5.2013**

**Gjykatësi,  
Zenel Leku**

**KESHILLE JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.